

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/B: 41118

Data/Datum: 26.01.18

PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër: Policinë e Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 214-17-4710-1-2-1

Nr i brendshëm 214/17/106/121

Sa i përket tenderit për: Furnizim me Alkotesta

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.SH."M.S.MEDICOM"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Major Mehmet Bushi H6/1

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+381 [REDACTED]

(Numri Telefonit)

+381 [REDACTED]

(Numri i Faks-it)

Edmond Obertinca

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[REDACTED]@ks.com

(Adresa elektronike)

26 Janar 2018

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe Vendi)

Medicom

Dräger authorized dealer

Major Mehmet Bushi H6/1 Tel. +381 38 546020
Prishtinë-Kosovë office@medicom-ks.com

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim nuk përmban asnjë arsyetim për pretendimet Ankimore, kjo pasi nuk adreson asnjë prej fakteve të cilat dëshmojnë se produkti i rekomanduar për Kontratë nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderid.

Në pjesën kryesore, Vendimi për Refuzimin Kërkesës për Rishqyrtim deklaroi se tek produkti i rekomanduar për Kontratë kemi të bëjë me devijime të vogla, kjo për kritere teknike për të cilat në Ankesën kundër specifikimeve teknike autoriteti Kontraktues me vendim ka theksuar so do e kërkojë tërësisht plotësimin e tyre.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Prodhuesi i favorizuar dhe rekomanduar për kontratë Envitec dhe kompania e dytë e shpallur e përgjegjshme, nuk i plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, përkundër se të dyja janë shpallur të përgjegjshme dhe njëra është rekomanduar për Kontratë.

Qëllimi i Autoriteti Kontraktues ka qenë diskriminimi, kjo pasi përmes kombinimit të specifikave më të larta teknike në Dosjen e Tenderit ka detyruar ofertuesit tjerë të ofertojnë me pajisje më të avansuar dhe me cmime më të shtrejta, kjo duke përfshirë edhe kërkesa për kohën prej 5 sekonda për fillimin e punës. Në anën tjetër, për produktet e favorizuara dhe të rekomanduara për kontratë, edhe pse nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit, në mënyrë të kundërligjshme i interpreton si devijime të vogla.

Përmes kësaj Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të Neneve në vijim:

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve – Operatori Ekonomik i rekomanduar për Kontratë me prodhuesin Envitec dhe pajisjen AlcoQuant 6020 Plus nuk i plotëson kushtet e tenderit. Gjithashtu as Operatori tjetër Ekonomik me pajisjen AlcoTrueP, i shpallur si i përgjegjshëm nuk i plotëson kushtet e Dosjes së Tenderit.

Neni 59, paragrafi 4 – Devijimet e vogla – mos përputhjet e pajisjes së rekomanduar për kontratë nuk mund të konsiderohen si devijime të vogla. Kjo për shkak se Vendimi i Policisë i datës 21 Nëntor 2017, duke vendosur në ankesën për specifikat teknike të dosjes së tenderit, ka theksuar se të gjitha specifikat kërkohej të plotësohen në mënyrë strikte. Kjo e ka detyruar operatorin ankues të ofertojë me pajisjen më të shtrejtë që i plotëson tërësisht kërkesat e larta të dosjes së tenderit.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale – Dy Operatorët Ekonomik të shpallur të përgjegjshëm me pajisjet e tyre, nuk i plotësojnë specifikat teknike të përcaktuara qartë në Dosjen e Tenderit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Aktiviteti Tenderues "Furnizim me Alkotesta" ka qenë aktivitet tenderues të cilin Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje serioze të legjislacionit tenderues me qëllim të favorizimit të pajisjes Envitec AlcoQuant 6020 Plus të prodhuesit Envitec, sikurse ka ndodhur edhe në gjashtë procedurat tenderuese të mëhershme për të njëjtin produkt, të dështuara për shkak të manipulimeve.

Dosja e Tenderit është përgaditur duke kërkuar karakteristika teknike të teknologjisë më të fundit dhe më të shtrejta, ku aplikimi i të gjitha specifikave të dosjes së tenderit përcakton se vetëm alkotestat më të shtrejtë të ofertohen, dhe jo alkotestat standard me cmim më të volitshëm të cilët përdoren nga shumica e policisë së Botës.

Me datë 17 Nëntor 2017 M.S.Medicom ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim në raport me Dosjen e Tenderit. Duke qenë të vetëdijshëm se kemi të bëjë me aktivitet tenderues të ndikuar dhe se produktet e prodhuesit të favorizuar Envitec nuk i plotësojnë kërkesat e Dosjes së Tenderit, në Kërkesën për Rishqyrtim kemi kërkuar uljen e standardeve teknike të larta të Dosjes së Tenderit. Kjo edhe për arsyen se kërkesat e larta të Dosjes së Tenderit do ndikonin në cmim shumë më të lartë të pajisjeve.

Me datë 21 Nëntor 2017 Autoriteti Kontraktues merr Vendim për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim në lidhje me specifikat e Dosjes së Tenderit. Policia ka konfirmuar se do të implementojë në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit në mënyrë strikte. **Në vendim për refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues në mënyrë specifike edhe një herë i rithekson se kërkon në mënyrë strikte plotësimin e kërkesave teknike dhe se ata kanë para për produkte të tilla, kjo duke përmendur në mënyrë specifike kërkesën për 5 sekonda për ndezje përdorim pas ndezjes së pajisjes, lgëshitisë relative të ajërit dhe margjinës së gabimit në testim.**

Operatori Ekonomik M.S.Medicom ka ofertuar me pajisjen Dräger Alcotest 7510, i cili paraqet pajisjen më të shtrejtë dhe më të avancuar në Botë në fushën e alkotestave. Kjo duke qenë të vetëdijshëm për konfirmimin e dyfishtë dhe strikt të Dosjes së Tenderit dhe specifikave teknike.